

Vendim nr. 29 datë 13.02.2023

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

Elsa Toska,	Kryesuese
Ilir Toska,	Anëtar
Genti Ibrahimi,	Anëtar

në datën 13.02.2023 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 37 (A) 2022 të Regjistrit Themeltar, që i përket:

KËRKUESE: **ANTONETA MARKEÇI (DIDA)**

OBJEKTI: **Shfuqizimi i vendimeve nr. 4274, datë 22.09.2016 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë; nr. 3851, datë 20.09.2017 të Gjykatës Administrative të Apelit dhe nr. 00-2022-1002, datë 13.05.2022 të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.**

BAZA LIGJORE: Nenet 42, 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; neni 153 i Kodit të Punës së Republikës së Shqipërisë; nenet 7 dhe 17, shkronjat “a” dhe “c” të ligjit nr. 49/2012, datë 03.05.2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, të ndryshuar; ligji nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*).

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (*Kolegji*), pasi dëgjoi relatoren e çështjes Elsa Toska, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Rrethanat e çështjes

1. Kërkuesja ka punuar si mësuese në shkollën 9-vjeçare “Koben”, Dibër nga data 09.12.2005 deri në datën 08.10.2007. Në vijim, ajo është transferuar si mësuese në shkollën 9-vjeçare “Kastriot”, ku ka punuar deri në datën 12.10.2009 dhe sërish është rikthyer mësuese në shkollën 9-vjeçare “Koben”, Dibër.

2. Me vendimi nr. 7, datë 18.09.2015 të drejtorisë së shkollës 9-vjeçare “Koben”, kërkuesja është liruar nga detyra me motivacionin se ka qenë e punësuar në këtë shkollë jashtë profilit të saj, si mësuese me arsim të lartë, profili “Gjeografi”, situatë e cila bie ndesh me ligjin nr. 69/2012, datë 21.06.2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”.

3. Kërkuesja i është drejtuar Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë me kërkesëpadi me objekt: *“1. Deklarimin e pavlefshëm absolutisht të largimit nga puna si mësuese në shkollën 9-vjeçare “Koben”, pa vendim për motivimin e largimit nga puna ku ka punuar nga data 09.12.2005 e deri në datën 18.09.2015. 2. Detyrimin e Drejtorisë Arsimore Rajonale Dibër për të më paguar nga data 01.12.2016 e në vazhdim, deri rikthimin në punë. 3. Kthimin në vendin e punës”, për të cilën gjykata, me vendimin nr. 4274, datë 22.09.2016, ka vendosur rrëzimin e saj.*

4. Për ankimin e kërkueses, me vendimin nr. 3851, datë 20.09.2017, Gjykata Administrative e Apelit ka vendosur ndryshimin e vendimit nr. 4274, datë 22.09.2016 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë; pranimin e pjesshëm të padisë; detyrimin drejtorisë së shkollës 9-vjeçare “Koben” t’i paguajë kërkueses: 2 paga mujore, si dëmshpërblim për shkak të mosrespektimit të procedurës së zgjidhjes së kontratës së punës; 10 paga mujore, si dëmshpërblim për zgjidhje të kontratës së punës në mënyrë të menjëhershme, pa shkaqe të justifikuara; 5 paga mujore si shpërblim për vjetërsi në punë; si dhe rrëzimin e padisë për kërkimet e tjera.

5. Drejtoria Arsimore Rajonale, Dibër (DRA, Dibër) ka ushtruar rekurs në Gjykatën e Lartë dhe, në datën 16.04.2018, ka paraqitur kërkesë për pezullimin e ekzekutimit të vendimit nr. 3851, datë 20.09.2017 të Gjykatës Administrative të Apelit.

6. Me vendimin nr. 253, datë 05.06.2018, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë ka vendosur pezullimin e ekzekutimit të vendimit nr. 3851, datë 20.09.2017 të Gjykatës Administrative të Apelit.

7. Me vendimin nr. 00-2022-1002, datë 13.05.2022, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë ka vendosur mospranimin e rekursit dhe revokimin e masës së pezullimit të

ekzekutimit të vendimit nr. 3851, datë 20.09.2017 të Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë, të dhënë me vendimin nr. 253, datë 05.06.2018 të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë.

8. Në datën 30.11.2022 kërkesja i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*) me kërkesë për shfuqizimin e vendimeve gjyqësore sipas objektit, duke pretenduar se i kanë cenuar të drejta kushtetuese.

II

Pretendimet e kërkeses

9. **Kërkesja** ka parashtruar, në mënyrë të përmbledhur, se i janë cenuar:

9.1. *E drejta për një proces të rregullt ligjor*, në drejtim të së drejtës për t'u dëgjuar, pasi gjykatat kanë vendosur rrëzimin e padisë pa e dëgjuar dhe pa siguruar provat e nevojshme për vendimmarrje.

9.2. *Parimi i barazisë para ligjit dhe mosdiskriminimit*, për shkak të standardeve të ndryshme të mbajtura nga gjykatat në dy raste të ngjashme me të saj në rrethin e Dibrës, për të cilat kanë vendosur rikthimin në punë.

9.3. *E drejta për të fituar mjetet e jetesës me punë të ligjshme*, pasi Kodi i Punës është vlerësuar nga gjykatat në mënyrë të njëanshme e sipërfaqësore dhe jo në përmbajtje, në drejtim të së drejtës së punëmarrësit për të kërkuar rikthimin në vendin e punës dhe shpërblimin për kohën e papunësisë.

III

Vlerësimi i Kolegjit

A. Për legjitimitetin e kërkeses

10. Çështja e legjitimitetit (*locus standi*) është vlerësuar nga Gjykata si një ndër aspektet kryesore që lidhet me inicimin e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor, që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret e nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike efektive, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësura në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës. Kriteret për

pranueshmërinë e kërkesës janë kumulative, në kuptimin që mjafton mosplotësimi i njërit prej tyre që kërkuuesi të mos legjitimohet për vënien në lëvizje të gjykimit kushtetues.

11. Si bartëse e të drejtave dhe lirive themelore të parashikuara nga Kushtetuta, kërkuuesja legjitimohet *ratione personae*, bazuar në nenet 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës, pasi ka qenë palë në procesin gjyqësor, ndaj të cilit ka ngritur pretendime në këtë Gjykatë dhe ka interes të drejtpërdrejtë në çështjen e parashtruar.

12. Lidhur me kriterin e *shterimit të mjeteve juridike efektive*, sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës, individ mund t’i drejtohet Gjykatës me ankim kushtetues individual vetëm pasi të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike efektive për mbrojtjen e të drejtave kushtetuese që ai pretendon se i janë cenuar. Shterimi i mjeteve juridike ka të bëjë me kontrollin subsidiar që ushtron Gjykata, përfshirë edhe rastet e shkeljes së të drejtave të individit (*shih vendimet nr. 4, datë 22.02.2022; nr. 14, datë 11.03.2021 të Gjykatës Kushtetuese*). Mjetet ligjore konsiderohen të shteruara kur, në varësi të rrethanave të çështjes, rregullat procedurale nuk parashikojnë mjete të tjera ankimi (*shih vendimet nr. 14, datë 21.06.2022; nr. 33, datë 01.11.2021 të Gjykatës Kushtetuese*). Ky rregull nënkupton jo vetëm që individ t’u jetë drejtuar të gjitha instancave të zakonshme, por edhe që të gjitha pretendimet që ngre në këtë Gjykatë t’i ketë paraqitur më parë në këto instanca, të paktën në substancë, duke respektuar kërkesat formale dhe afatet e parashikuara në ligjin procedural (*shih vendimin nr. 19, datë 07.07.2021 të Gjykatës Kushtetuese*).

13. Në rastin konkret, Kolegji vëren se pretendimin për cenimin e parimit të barazisë para ligjit dhe mosdiskriminimit kërkuuesja nuk e ka ngritur në ankimin e saj drejtuar Gjykatës Administrative të Apelit. Për rrjedhojë, në lidhje me këtë pretendim, ajo nuk ka shteruar mjetet juridike, në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja “f”, të Kushtetutës dhe nenit 71/a, pika 1, shkronja “a”, të ligjit nr. 8577/2000. Ndërkohë, pretendimet për cenimin e së drejtës për t’u dëgjuar dhe së drejtës për të fituar mjetet e jetesës me punë të ligjshme i ka ngritur, në thelb, në gjykatat e juridiksionit të zakonshëm, për rrjedhojë, në lidhje me këto pretendime, Kolegji vlerëson se ajo i ka shteruar mjetet juridike efektive në dispozicion përpara se t’i drejtohet Gjykatës.

14. Për sa i takon legjitimitet *ratione temporis*, neni 71/a, pika 1, shkronja “b”, i ligjit nr. 8577/2000 ka parashikuar afatin 4-mujor nga konstatimi i cenimit për paraqitjen e ankimit kushtetues individual. Kolegji vëren se vendimi i kundërshtuar i Gjykatës së Lartë mban datën 13.05.2022, ndërsa kërkesa është paraqitur në Gjykatë në datën 30.11.2022. Në lidhje me përmbushjen e këtij kriteri, kërkuuesja ka pretenduar se ka marrë dijeni për këtë vendim në datën

05.09.2022, përmes shkresës nr. 4090/1 prot., datë 31.08.2022 të Gjykatës së Lartë, pas kërkesës së saj për vënie në dispozicion të kopjes së tij.

15. Sipas informacionit të marrë nga Gjykata e Lartë për këtë qëllim, Kolegji evidenton se vendimi i arsyetuar i Gjykatës së Lartë, objekt i ankimit kushtetues, është bërë i disponueshëm për palët në datën 09.06.2022 dhe është publikuar në faqen zyrtare të gjykatës në datën 10.06.2022. Në këto kushte, Kolegji vlerëson se ankimi kushtetues individual është paraqitur jashtë afatit 4-mujor të parashikuar nga ligji nr. 8577/2000, për rrjedhojë kërkesja nuk legjitimohet *ratione temporis* në kërkesën e saj sipas objektit.

16. Për sa më lart, Kolegji çmon se ankimi kushtetues individual nuk plotëson kriteret ligjore paraprahe për shqyrtim në seancë plenare.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, në bazë të neneve 31, dhe 31/a, pika 2, shkronja “ç”, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

V E N D O S I:

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.